

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" UNIVERSITY OF PRISHTINA Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

#### UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

> Nr. Prot.: 1417 Datë: 08/07/2016

## REGULATION ON ESTABLISHMENT OF THE ADVISORY BOARD

Pursuant to Article 6, item 1.2, Article 13, item 1.14, Article 48, item 1.9 of the Statute of the University of Prishtina "Hasan Prishtina", the Council of Faculty of Mechanical Engineering in the meeting held on 01.06.2016, adopted:

## REGULATION

on Establishment and Functioning Principles of the Advisory Board of Faculty of Mechanical Engineering / University of Prishtina "Hasan Prishtina"

## **Purpose**

This Regulation determines the character, membership, function, scope, decision-making manner, and mandate of the Advisory Board.

## Article 1

- 1. Advisory Board (hereinafter AB), established on the basis of the Statute of the University of Prishtina "Hasan Prishtina" (hereinafter UP) and of this Regulation is of a *non-profit and advisory* character and is based on the goodwill of the members and the commitment of the Faculty of Mechanical Engineering (hereinafter FME) and the UP to increase the quality of Higher Education within the scope of FME activities.
- 2. Advisory Board is composed of representatives of the labor market and of the authorities in the scope of the respective FME.
- 3. Board composition and activities are published on the FME website.

#### Article 2

- 1. Advisory Board shall be established by the Faculty of Mechanical Engineering on the proposal of the Dean.
- 2. Advisory Board may have more than 11 members...
- 3. Dean of the FME shall propose the members of the Advisory Board, whose appointment is approved by the Council of FME.
- 4. After the establishment of the Advisory Board and the election of the Chair, other members of the Advisory Board may be proposed. The Dean shall inform the Faculty Council of the FME of their election.

#### Article 3

- 1. Advisory Board is composed of labor market representatives who are decision-makers in private or public companies as well as representatives of governmental authorities relevant to the scope of the FME.
- 2. *Ex-officio* members of the Advisory Board are the Dean and Vice-Deans of the FME as well as one representative from the University or any of the faculties of similar scope.
- 3. The Dean of the FME prepares the constitutive meeting of the Advisory Board, compiles the materials related to the agenda and undertakes other activities related to the work of the Advisory Board.

#### Article 4

- 1. Advisory Board shall elect the Chair from among the representatives of the labor market. The Chair of the Advisory Board conducts the meetings and ensures that information regarding the meetings is exchanged with all its members and other stakeholders.
- 2. According to this Regulation as well as best and transparent practices, the Chair of the Advisory Board takes care of the summary of the AB work reports and operationalization of its initiatives.
- 3. The Chair of the Advisory Board shall represent the AB in relation to the third party. In his absence, the Chair may appoint a deputy.
- 4. The Chair of the Advisory Board shall introduce the AB work to various organizations, such as the Council of the FME, higher education institutions domestically and abroad, thematic workshops, etc.

- 5. Advisory Board may set up working groups to focus on specific areas of scope of the relevant FME in the labor market.
- 6. Depending on topics that are discussed, the heads of departments, the director of the FME Institute, and representatives of relevant bodies operating within the FME, may be invited at the Advisory Board meetings without having the right to vote.

#### Article 5

- 1. Advisory Board may recommend to the Council of the FME to update its study programs.
- 2. AB members support the realization of the professional practice of FME students in accordance with study programs.
- 3. Advisory Board supports the FME and the labor market in the respective scope for setting up the joint working groups.
- 4. Advisory Board and the FME collaborate on scientific research, professional services, project co-operation, innovation mediation, as well as proposals for co-operation in joint projects with FME and other partners.
- 5. AB members can provide scholarships for students as well as financial support for the research projects of students and academic staff.
- 6. Advisory Board may consider other issues proposed by the Dean of FME.

#### Article 6

- 1. Advisory Board may suggest changing, improving and amending regulations and other applicable acts.
- 2. Advisory Board may propose to the AU Council programs relating to lifelong learning, tertiary education, and vocational training.
- 3. Advisory Board makes assessments, recommendations and suggestions regarding working conditions, laboratories and facilitating the functional performance.
- 4. Advice and suggestions of AB on issues handled will be addressed to the Council of the FME, UP Senate, UP Management and Steering Council, in terms of drafting new programs, applying for the accreditation process, assigning practical work, planning research projects and the evaluation thereof, drafting strategic documents, etc.

## **Article 7**

- 1. Approval of the proposals is made by a simple majority of the members present.
- 2. Recommendations of the Advisory Board in the form of proposals are submitted to the Council of the FME for further elaboration.

## **Article 8**

- 1. The mandate of AB members shall be 4 (four) years, with the possibility of re-election. The number of mandates is not limited.
- 2. At the invitation of the Dean, the AB Chair may present to the FME Council the AB activities for the specified period.

#### Article 9

1. This regulation enters into force on the date of approval by the Council of the Faculty of Mechanical Engineering.

Prishtina, date 08.07.2016

Dean of FME Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala



#### UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

. Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Teb +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pnedu • www.uni-pnedu

> Nr. Prot.: 1417 Datë: 08/07/2016

## RREGULLORE PËR THEMELINIM E TRUPIT KËSHILLËDHËNËS

Në bazë të nenit 6, pika 1.2, nenit 13, pika 1.14, nenit 48, pika 1.9, nenit 65, neni 76, dhe nenit 87, pika 2, të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2016, miratoi këtë:

## RREGULLORE

për themelimin dhe parimet e funksionimit të Trupit Këshillëdhënës të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

## Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësimin, funksionimin, fushëveprimin, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Trupit Këshillëdhënës.

## Neni 1

- 1. Karakteri i Trupit Këshillëdhënës (në tekstin e mëtejmë TK), të themeluar në bazë të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejmë UP) dhe të kësaj Rregulloreje, *është jo fitimprurës dhe këshillëdhënës* dhe bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe përkushtimin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (në tekstin e mëtejmë FIM) dhe UP-së për ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e veprimtarisë së FIM-it.
- 2. Trupi Këshillëdhënës përbëhet nga përfaqësuesit e tregut të punës dhe të autoriteteve nga fushëveprimtaria e FIM-it.
- 3. Përbërja dhe aktivitetet e Trupit publikohet në web faqen e FIM-it.

### Neni 2

- 1. Trupin Këshillëdhënës e themelon FIM-i me propozimin e Dekanit.
- 2. Trupi Këshillëdhënës mund të ketë me shumë se 11 anëtarë.
- 3. Dekani i FIM-it i propozon anëtarët e Trupit Këshillëdhënës, emërtimin e të cilëve e miraton Këshilli i FIM-it.
- 4. Pas konstituimit të Trupit Këshillëdhënës dhe zgjedhjes së kryetarit, mund të propozohen edhe anëtarë tjerë të Trupit Këshillëdhënës. Për zgjedhjen e tyre, dekani e informon Këshillin e Fakultetit.

#### Neni 3

- 1. Trupi Këshillëdhënës përbëhet nga përfaqësues të tregut të punës që janë vendimmarrës në kompani private apo publike si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare relevante për fushëveprimtarinë e FIM-it.
- 2. Anëtarë *ex-officio* të Trupit Këshillëdhënës janë Dekani dhe Prodekanët e FIM-it, si dhe një përfaqësues nga Universiteti ose ndonjë prej fakulteteve me fushëveprim të ngjashëm.
- 3. Dekani i FIM-it përgatit mbledhjen konstitutive të Trupit Këshillëdhënës, përpilon materialet lidhur me rendin e ditës dhe ndërmerr aktivitete tjera për mbarëvajtjen e punës së Trupit Këshillëdhënës.

## Neni 4

- 1. Trupi Këshillëdhënës e zgjedh Kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari i TK-së i udhëheqë mbledhjet dhe kujdeset që informatat lidhur me mbledhjet të jenë shpërndarë të të gjithë anëtarët e vet dhe palët tjera të interesit.
- 2. Sipas kësaj rregulloreje dhe praktikës së mirë dhe transparente, Kryetari i Trupit Këshillëdhënës përkujdeset për përmbledhjen e raporteve të punës së TK-së dhe operacionalizimin e iniciativave të tij.
- 3. Kryetari i Trupit Këshillëdhënës e përfaqëson TK-së në raport me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit, ai mund të caktoj një zëvendës të tij.
- 4. Kryetari i Trupit Këshillëdhënës e prezanton punën e TK-së në organizime të ndryshme, si: Këshill të FIM-it, institucione të arsimi të lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike, etj.

- 5. Trupi Këshillëdhënës mund të formoj grupe punuese që përqendrohen në lëmi të veçanta të fushëveprimit të FIM-it dhe tregut të punës.
- 6. Varësisht nga temat për diskutim, në mbledhjet e Trupit Këshillëdhënës mund të ftohen udhëheqësit e programeve studimore (shefat e departamenteve), drejtori i Institutit të FIM-it dhe përfaqësues të organeve përkatëse që funksionojnë në kuadër të FIM-it, pa të drejtë vote.

#### Neni 5

- 1. Trupi Këshillëdhënës mund t'i sugjeroj Këshillit të FIM-it përditësimin e programeve të studimeve.
- 2. Anëtarët e TK-së mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të FIM-it, në pajtim me programet e studimeve.
- 3. Trupi Këshillëdhënës mbështet FIM-in dhe tregun e punës të fushë veprimtarisë punuese në krijimin e grupeve të përbashkëta punuese.
- 4. Trupi Këshillëdhënës dhe FIM-i bashkëpunojnë në kërkime shkencore, shërbime profesionale, bashkëpunime në projekte, ndërmjetësim për inovacione, si dhe në propozime për bashkëpunim në projekte të përbashkëta me FIM-it dhe partner të tjerë.
- 5. Anëtarët e TK-së mund të ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe stafit akademik.
- 6. Trupi Këshillëdhënës mund të shqyrtoj edhe çështje tjera të propozuara nga Dekani i FIM-it.

## Neni 6

- 1. Trupi Këshillëdhënës mund të sugjeroj ndryshimin, përmirësimin dhe amandamentimin e rregulloreve dhe akteve tjera në fuqi.
- 2. Trupi Këshillëdhënës mund ti propozoj Këshillit të FIM-it programe që kanë të bëjnë me: mësim tërëjetësorë, aftësimin e të rriturve dhe trajnime profesionale.
- 3. Trupi Këshillëdhënës bënë vlerësime, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
- 4. Këshillat dhe sugjerimet e TK-së për çështjet e trajtuara, do t'i adresohen Këshillit të FIM-it, senatit të UP-së, menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të UP-së, në kuadër të: hartimit të programeve të reja, aplikimit për proces të akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit projekteve kërkimore-shkencore, vlerësimit të tyre, hartimit të dokumenteve strategjike, etj.

## Neni 7

- 1. Aprovimi i propozimeve bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
- 2. Rekomandimet e TK-es në formë të propozimit dorëzohen në Këshillin e FIM-it për procedim të mëtutjeshëm.

## Neni 8

- 1. Mandati i anëtarëve të TK-es zgjasin 4 (katër) vite, me mundësi të rizgjedhjes. Numri i mandateve nuk është i kufizuar.
- 2. Me ftesën e Dekanit, Kryetari i TK-es mund të prezantoj para Këshillit të FIM-it aktivitetet e TK-es për periudhën e caktuar.

## Neni 9

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Prishtinë, me 08.07.2016

Dekani i FIM-it Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala